

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **642-25-2327-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Trajtimi i qenëve që bredhin lirshëm në Komunën e Mitrovicës - qentë endacak**

Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

S.V., VETERINA “

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Qameris nr. 65

(Adresa)

Vushtrri

(Vendi)

42000

(Kodi postar)

044/147 297

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Safet Osmani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

abulanca1@gmail.com

(Adresa elektronike)

27.10.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me **PROKURË**.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) (Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) (Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë”apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”,nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: **15.04.2025**

Hapja e ofertave date:**14.08.2025**

B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së me date: **22.10.2025**

Letra standarde për tenderuesin e pasukseshem apo/ose eliminuar MUNGON nuk kemi pranuar nga AK duke shkelur nenin 42 te rreg. Nr. 001/2022 per PP

Kërkesa për rishqyrtim nga **S.V., VETERINA — Vushttri** me date: **27.10.2025**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Në hapjen e këtij aktiviteti të prokurimit nuk kemi marr pjesë sepse ishte elektronike përmes platformës e-prokurimi dhe konsiderojmë se ka qenë në rregull procesi i hapjes.

Por proces verbali i hapjes është ngritur në platformën elektronike me date 14.08.2025.ora - 13:50

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

KUVENDI KOMUNAL MITROVICË – ka shkelur këto Dispozita Ligjore të LPP-së, si ne vijim:

1. Neni 1 të LPP-së
2. Neni 2 të LPP-së
3. Neni 6 të LPP-së
4. Neni 7 të LPP-së
5. Neni 24 te LPP-së
6. Neni 52 par. 7 të LPP--së.
7. Neni 55 të LPP-së.
8. Neni 56 i LPP-së
9. Neni 59 par. 1, 2 dhe 4 të LPP-së
10. Neni 60 par. 1.1 te LPP-së.
11. Neni 62 të LPP-së
12. Neni 40.3 40.6; 40.7 dhe 40.8 të Rreg. Nr. 001/2022 per PP
13. Nenin 42 te Rreg. Nr. 001/2022 per PP
14. Nenin 43.5 te Rreg. Nr. 001/2022 per PP
15. Nenin 45.1 deri ne nenin 45.29 te Rreg. Nr. 001/2022 per PP

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshtetja rrethana faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

AK – **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**, me datë: **22.10.2025**, përmes platformës elektronike e-prokurimka publikuar në platformën elektronike e-prokuirm - B58 Njoftimi mbi vendimin e AK, për këtë aktivitet të prokurimit, që do thotë se me këtë rast ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-së, dhe Rreg. Nr. 001/2022 për PP versionin e konsoliduar, të cilat do të argumentojmë dhe dëshmojmë me prova dhe fakte konkrete si në vazhdim të kësaj KpR.

Prove: AK ka vonuar vlerësimin nga procesi i hapjes së plotë **69 DITE**, që është absurditet i llojet e vete për faktin se arropan me bler për 69 ditë s'ka arsye logjike dhe as ligjore me zgjatje vlerësimi të tenderëve, kjo bie ndesh me **nenin 40.3 të Rreg. Nr. 001/2022 për PP - versionin e konsoliduar**, që shumë qartë e specifikon **30 ditë + 20 ditë** raste të arsyetuar, dhe përkundrazi kësaj AK nuk ka arsyetuar vazhdimin dhe vlerësimin për plotë 83 ditë?!... Kjo lene mjaft hapësirë dhe dyshim për procesin e vlerësimit jo të drejtë dhe në shkelje edhe të dispozitave të tjera të LPP-së!.....

SQARIME për këtë AP si në vijim:

Andaj duke marrë për bazë dispozitat ligjore të LPP-së, **ne si OE me palë me interese sipas nenit 4 par. 1.26 të LPP-së**, edhe për kundër faktit se në kemi arritur të plotësojmë të gjitha kriteret e përzgjedhjes të përcaktuar në dosjet e tenderit dhe njoftimin për kontratë, mirepo AK– ZPP duke shkelur dispozitat ligjore të LPP, duke anuluar në shkelje të nenit 59, 60 dhe 62 të LPP-së, duke në diskriminuar, NE si OE po detyrohemi të parashetrojmë **Kërkesë për Rishqyrtim** pranë AK duke pasqyruar dhe një herë faktet dhe argumentet lidhur me ARSYTIMIN NGA ANA JONE - SE **AK - ZPP KA SHKELUR NENIN 62 të LPP-së** si në vijim po citojmë:

ARSYTIM:

AK me rastin e publikimit të NJK dhe DT ka përcaktuar duke zgjedhur procedurën e prokurimit – Procedure e hapur - **KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË – SHËRBIM - Me Një Operator Ekonomik**, ku në dokumentin themelor për përgaditjen e tenderëve në dosjet e tenderit ka përcaktuar këto kushte të nenit 26 të Dosjes së tenderit

Vlera e Parashikuar	2.6	Vlera totale e parashikuar: 400,000.00 EURO Viti 2025: 100,000.00 EURO Viti 2026: 150,000.00 EURO Viti 2027: 150,000.00 EURO
---------------------	-----	---

ARSYTIMI nga ZPP në B58 – njoftimi mbi vendimin e AK – duke e anuluar me arsyetime të cilat përveq se nuk gjene mbështetje të nenit 62 të LPP-së si dhe rregullores nr. 43.5 të Rreg. Nr. 001/2022 për PP – versionin e konsoliduar, Po ashtu nuk ka ofruar PROVA dhe FAKET që e dëshmojnë një veprim të tillë sepse Dispozitat ligjore të LPP-je janë shumë të qarta kur dhe si mund të ANULOHEJ një AP pas kësaj ndodhur Proceverbali i hapjes dhe ku dëshmohet se kanë tenderuar 3 (tre) operator ekonomik dhe në jemi tenderues në këtë aktivitet të prokurimit ku kemi arritur të plotësojmë të gjitha kriteret e përzgjedhjes në DT dhe NJK, si dhe anulimi në këtë fazë është në shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së.

ZPP ne B58 – njoftimin mbi vendimin e AK te dates 22.10.2025 prpiqet te arsyetoj shkeljen e vete per te cilen eshte i PLOTESISHT i vedijshem per shkeljet ligjore por mundohet ti arsyetoj se kinese ne munges te mjeteve po pa asnjë prove dhe fakt konkret si ne vijim po e bashkëlidhim me shkrin shoot:



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo
KOMUNA E MITROVICËS JUGORE
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



**NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR
ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT**

Sipas Nenit 43.5 dhe 44.2 të Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Titulli i aktivitetit: "Trajtimi i qenëve që bredhin lirshëm në Komunën e Mitrovicës - qentë endacak".

Datë: 22.10.2025

Komuna e Mitrovicës Jugore

Nr. i Prokurimit:	642-25-2327-2-1-1
Nr. i brendshëm:	642-25-002-2-1-1

Nr.	Emri dhe Adresa e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në tender procedur	Vlera totale e peshuar/poentuar €
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik: MITRO VET SH.P.K.; S.V.Pharmacion Vet SH.P.K.	55.35 €
2.	Operatori Ekonomik: S.V.,Veterina	93.90 €
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik: Ambulanca Veterinare Veterinaria; BLENDOR KADRIU B.I.	122.38 €

Rezultati i aktivitetit të prokurimit: "Trajtimi i qenëve që bredhin lirshëm në Komunën e Mitrovicës - qentë endacak".

Arsyetim për ANULIM

Autoriteti Kontraktues duke u bazuar në Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092., si dhe Rregullorën Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, jemi të obliguar të **Anulojmë** procedurën e prokurimit për arsye se edhe pas përpjekjeve të shumta për sigurimin e mjeteve nga Autoriteti Kontraktues – ZKF dhe ZKA që ti zotojn mjetet financiare për këtë aktivitet të prokurim ku ne ju kemi drejtuar me kërkesë për rikonfirmimin e mjeteve financiare dhe përgjigja nga ana e tyre ka qenë se ka ndodhur ndryshim në ndarjet buxhetore të miratuara për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Trajtimi i qenëve që bredhin lirshëm në Komunën e Mitrovicës - qentë endacak"**, ku si pasojë, mjetet buxhetore të parapara për këtë projekt nuk janë më të disponueshme në nivelin e kërkuar për realizimin e kontratës. Andaj, Autoriteti Kontraktues **ANULON** procedurën e prokurimit për arsye si më lart, se edhe pas përpjekjeve dhe pritjeve nga Njesia e Kërkesës dhe Njesia e Buxhetit dhe Financave për sigurimin e mjeteve financiare shtesë nuk ka mundur të sigurohen nga Autoriteti Kontraktues apo Njesia e Kërkesës dhe Njesia për Buxhet dhe Financa, ku sipas nenit **43.5 pika i) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi.**

Pas përmirësimit të planifikimit të buxhetit për vitet në vijim procedura do të ri-inicohet përmes ritenderimit.



Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit

Prandaj, arsyetimi dhene nga ZPP pa ofruar asnjë prove dhe fakte si dhe duke mos e mbeshtet ne

dispozite ligjore te Prokurimit dhe as Rregullores nr. 001/2022 pasi qe neni 43.5 i rregullores ne fjale nuk eshte arsyetim per faktin se KY aktivitet i prokurimit eshte zhvilluar permes procedures se hapur, dhe eshte kontrate kornize per 36 muaj me nje operator ekonomik, sikur eshte sqaruar ne DT ne nenin 5.4 ne dosjen e ternerti si dokument themelor per pergaditjen e tenderve, ku thote:

	5.4	Dërgesat do të kryhet VETËM pas dhënies së "urdhër blerjes" që do të lëshohet nga Autoriteti Kontraktues, gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate publike kornizë. Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 36 muajsh dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi.
--	-----	--

Prandaj, Nga dëshmia e lartcekur shihet qartë se AK-ja nuk ka dhënë asnjë arsyetim ANULIMIN e AP. E njëjta e ka cekur se nga konstatimet e lartcekura te dosjese se tendenderit si dhe as Dispozitave te LPP-se, mirëpo AK-ja nuk ka bërë asnjë konstatim të cilit mund ti referohemi sepse mungojn provat faktet dhe argumentet. Në këtë rast e njëjta pasi që nuk ka mundur në asnjë mënyrë të dëshmoj të kundërtën e pretendimeve tona ankimore, vetëm e ka ANULUAR aktivietin e prokurimit pa ndonjë arsyetim, sepse nëse eventualisht dot e posedonte fakte dhe argumentet dot e bashkëngjitet ne kete B58-njoftimim mbi vendimin e AK, atëherë AK-ja do ta dëshmonte me fakte konkrete një gjë të tillë mirëpo që nuk e ka bërë.

Mirepo edhe sikur te kishte, perseri ky aktivitet i prokurimit eshte projekt 3 vjeqar, Kornize, dhe mund te mungojn mjetet per kete vite buxhetoret mirepo ne vitet ne vijim AK ka siguruar mjetet dhe sikur te nënshkruhet edhe tani kontrate per kete vite eshte problem te ekzekutohen shërbimet sepse jemi ne përfundim te vitit dhe nuk qendron arsyetimi per anulimi e AP, duke marr per baze edhe Pershkrimin e cmimeve, i cili eshte me POENTIM qe dot e thote sasi eshte 1 (nje) - cope dhe varësisht nga nevoja e autoritetit kontraktues si dhe nga urdherblerja dot e ekzekutohen shërbimet pasi qe njesia kerkues – AK nuk e din sasin dhe nuk e din vleren e sakte te realizimit te sherbimve sepse kjo përcaktohet nga nevoja ne teren e AK – Njesie kerkuese, prandaj AK ka parashikuar vetem Vleren e parashikuar, por vlere e sakt e realizimit eshte e pa percaktuar dhe ketu ZPP vetm me nje zotim prej 1,000.00 € euro dot e mund te lidhe kontratn dhe te nënshkruaj per faktin se kjo eshte kontrate korniz per 3 vite dhe realizimi i saj përcaktohet nga nevoja dhe nga mjetet montare te percaktuar per kete sherbim.

Mungesa e mjeteve financiare Edhe pse si Autoriteti Kontraktues ne arsyetim kanë përdorur mungesën e mjeteve financiare si bazë për eliminim, kjo çështje është trajtuar edhe eme Ligjin mbi Financat Publike dhe është konstatuar se nuk përbën arsye të ligjshme për eliminim apo anulim të procedurës. Në këtë kontekst, përgjegjësia për këtë aspekt nuk bie mbi operatorin ekonomik, por është kompetencë dhe obligim i vetë Autoritetit Kontraktues që të ketë siguruar mjetet financiare për realizimin e kontratës.

AK - ZPP, gjegjësisht RrPP, neni 43.5 specifikon qarte se kur AK ka te drejt te anuloj një procedure te prokurimit pas hapjes se ofertave. Me këtë rast AK bënë shkelje të LPP, gjegjësisht RrPP, neni 43.5, sepse nuk ekziston asnjë arsyetim i bazuar në këtë nen që i lejon AK të anulojë tenderin në fjalë, citojmë:

43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsytet e mëposhtme:

- asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
- numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);
- nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;

- e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
- f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- g. asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
- h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
- i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
- j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-së është i pariparueshëm; ose
- k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

Arsytimi i AK – ZPP në piken 1. Se një shkelje e LIGJIT ka ndodhur, cila është ajo shkelje që s'mund të rregullohet, mungesa mjeteve në kontrata kornize për periudhë 3 vjeçare, nuk mund të anulohet AP, duke shtuar edhe faktin se sasia e përcaktuar tek përshkrimi i cmimeve është vetëm 1 (një) që do të thotë se vlera e kontratës që do të shpenzohet është e pa përcaktuar e pa njohur për AK – NJK, mirepo kjo përcaktohet nga nevoja dhe Urdherbërja që e leshon AK drejtuar operatorit ekonomik.

Prandaj, marr për bazë faktet dhe argumentet të cilat shume lehtë mund të dëshmojnë edhe në platformën elektronike e-prokurim, që AK – ZPP ka ngarkuar në për këtë aktivitet të prokurimit dëshmojnë se në këtë fazë ky aktivitet prokurimit për mungesë të mjeteve financiare nuk mund të anulohet. Gjithashtu kjo bie ndesh edhe me vetveten sepse dispozitë ligjore që u thirre për anulim është një shkelje ligjore, ndërsa në arsyetim thotë për mungesë të mjeteve financiare që do të thotë se shume qartë konstatohet se AK me rastin e anulimit të këtij AP ka shkelur nenin 62 të LPP-së.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me **nenin 59 LPP-së** dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, sipas **nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së**.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “*Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*”, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontratë.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktues në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga AK-ja – ZPP që të marr:

V E N D I M

APROVOHET, - si të bazuar Kërkesën për Rishqyrtim nga OE: S.V., VETERINA “

ANULOHET, - njoftimi mbi vendimin e AK-se për Anulimin e Aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në **RIVLERESIM, -** Autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konforme dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente, dhe do të kërkojmë llogari përmes rrugëve ligjore nga të gjithë palët që kanë marr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet material janë të mëdha në përgatitjen e këtij tenderi dhe KpR në vlerën: **450 Euro**, Deme tjera materiale të shkaktuar janë edhe angazhimi i stafit profesional dhe teknik për këtë projekt mund të mbesin pa keto të ardhë që mund të marrin me ekzekutimin e këtij projekti, si dhe deme tjera materiale **jane 3 – 5 % e fitimit të humbur** nga ky projekt pasi që jemi OE i përgjeshëm në këtë AP.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitnikërkesësdokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*